



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 200 Prot

Datë 24.01.2025

P/VENDIM

Nr. 05 Date 24.01.2025

**" PËR MIRATIMIN E LISTËS TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË
PERMIRESIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PER BASHKINE FUSHE-ARREZ PER
VITIN 2025"**

Bazuar ne Ligiin nr.22/2018, "Per Strehimin Social", Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, VKM :362 date 29.05.2019, "Për kriteret e dhënies së subvencionit te qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe menyren e llogaritjes se tij", VKM Nr.384, date 12.06.2019 "Per përcaktimin e dokumentacionit per te përfituar strehim sipas çdo programi social te strehimit dhe të afateve e të procedurave te miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr.459 datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.11 datë 07.01.2025 për "Ngritjen e Komisionit të Strehimit për vitin 2025", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Komisionit te Strehimit per vitin 2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e listes emërore të përfituesve për përmirësimin e banesave ekzistuese për vitin 2025 per komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara.

(Bashkelidhur tabela me listën emërore).

2. Të miratojë shumën me vlerë totale prej **8,847,000** lekë për përmirësim të banesave ekzistuese për periudhën Janar-Dhjetor për vitin 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit në vlerën prej **7,077,600** lekë, dhe në masën 20% nga Bashkia Fushë-Arrëz në vlerën **1,769,400** lekë.

3. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë për Komisionin e Strehimit per vitin 2025.

4. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Drejtoria e Diaspores, Migracionit, Çeshtjeve sociale, dhe Projekteve, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Finances dhe Tatimeve.

Zyra e Çështjeve sociale

Drejtoreshë
Sidorela Katroshi

Kryetari i Bashkisë
HIL CURRI

Juriste
Redona Hasani

Zyra e Finances
Përgjegjës
Dritan LIKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 200/17 Prot

Datë 24.01.2025

RELACION

Mbi Projektvendimin

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË
PERMIRESIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PER BASHKINE FUSHE-ARREZ PER
VITIN 2025.”**

Ky Projekt-Vendim është hartuar në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 24 "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale", pika 3, ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Hartimi dhe për zgjedhja nga Komisioni i Strehimit sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.11 datë 07.01.2025 për "Ngritjen e Komisionit të Strehimit për vitin 2025". Lista përfituese është bërë në bazë të VKM Nr. 362 date 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij" ku përparësi në subvencionimin e qirasë, sipas VKM nr.384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", kategoritë e përcaktuara në nenet 33 dhe 34/3 të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" si mëposhtë: a) Individët me statusin e jetimit, b) personat me aftësi të kufizuara, c) Të moshuarit, d) Invalidët e punës, Emigrantët e rikthyer, dh) Familjet e policëve të rënë në detyrë, e) Puntori emigrant, ë) Azil-kërkuesit, f) Familjet e komunitetit Rom, g) Familjet e komunitetit Egjiptian, gj) Viktimat e dhunës në familje, h) Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, i) Prindërit e vetëm , që kanë në ngarkim fëmijë, j) Individët, që i përkasin komunitetit LGBTI, k) Të mitur, 14-18 vjeç, dhe të rinj, 18-21 vjeç, në konflikt me ligjin, l) Vajzat nëna, pas daljes nga programi banesave sociale të specializuara, II) Familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas Aktit Normativ me Fuqinë e ligjit Nr.3, date 1.3.2012.

Nivel të ardhurash i cili matet mbi nivelin e konsumit të detajuar sipas madhësisë së familjes për cdo qark sipas INSTAT për vitin e fundit.

Bashkelidhur, tabela me familjet e propozuara sipas kriterëve të përzgjedhjes neni 16 i ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social" për përfitimin e subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit.

Zyra e Çështjeve sociale
Drejtoreshë
Sidorela Katroshi

Juriste
Redona Hasani

Kryetari i Bashkisë
Hil CURRI

